



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 03.11.2023)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 13:18 dhe mbaroi në orën 13:24.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>3. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>4. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>5. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>7. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami; Gjithashtu nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Fatmira Luli, znj. Brikena Ukperaj dhe znj. Irena Plaku.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 2. Staf administrativ i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Çështja e cila është për trajtim, sipas njoftimit të bërë, në rendin e ditës datë 03.11.2023, ora 13:00, lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën zoti Kurushi për të vijuar me relatimin e relacionit të përgatitur për caktimin e gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Deri më datë 02.11.2023, pranë KLGJ-së, është regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, të Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme: Bëhet fjalë për 1 çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t’i nënshtrohet shortit elektronik, sipas tabelës në relacion).

Kërkohet caktimi i 1 (një) gjyqtari për plotësimin e trupit gjykues në çështje penale të themelit me të pandehur {...} etj. Seanca gjyqësore është caktuar në datën 06.11.2023. Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}. Me vendimin nr. 6, datë 27.10.2023 të Këshillit të Gjykatës është vendosur zëvendësimi i gjyqtares {...}. Kanë pengesë gjyqtarët {...} – gjyqtare e hetimit paraprak; {...} ka disponuar si gjyqtare e hetimit paraprak në gjykatën e shkallës së parë për këtë çështje penale; Gjyqtare {...} – gjyqtar e hetimit paraprak; {...} – gjyqtar i hetimit paraprak; {...} ka disponuar për të bashkëpandehurin në procedim të lidhur; {...} ka disponuar për të bashkëpandehurin në procedim të lidhur; {...} ka disponuar për të bashkëpandehurin në procedim të lidhur.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Gjykata nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë gjykata e apelit të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtari për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhet me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën dhjetë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm znj. {...}, si edhe znj. {...} të cilës në dhjetor 2023 i fillon mandati si anëtare në KLGJ-së.

Bashkëlidhur relacionit është edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore që plotësojnë kriteret për t’iu nënshtruar shortit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa nr. 900), gjyqtarja Miranda Andoni.

Mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor